

## STATUTI

*Në këtë statut:*

*-“Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare;*

*-“Statuti” është Statuti i shoqërisë;*

### **KREU I**

*Themelimi, Emri, Objekti, Selia*

#### **Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- (1) Sot, më datë 20.09.2019, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **GAIA CONSULTING SOLUTIONS SHPK**
- (2) Themeluesit e shoqërisë janë Znj. Gerta KOSOVA me leternjoftim Nr. 034705165, Nr. personal I95611054G dhe Z. Michele De Cristofaro me pasaportë Nr. YA0870092.

#### **Neni 2**

##### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Import-Export, konsulencë financiare, konsulencë juridike, shitje me pakicë, energji të rinovueshme, ndërtim, turizëm, menaxhim hoteli, bar restorant, agroturizëm, ferma buqësore, peshkim, realizim projektsh, Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Import-Export, konsulencë financiare, konsulencë juridike, shitje me shumicë dhe shitje me pakicë, energji të rinovueshme, ndërtim, turizëm, menaxhim hoteli, bar, restorant, agroturizëm, ferma buqësore, peshkim, realizim projektsh, konsulence biznesi në të gjitha format dhe sektoret, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin operacional, dhenien e shërbimeve me çdo gjë që ka të bëjë me organizimin e një shoqërie tregtare për të tretë duke filluar nga menaxhimi dhe organizimi operacional, trajnimi i personelit, marketing, gjetja dhe hapja e tregjeve të reja të shitjes si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare, perkthime, projektim, zbatim, organizim industrial të çdo lloji natyre, gjetje hapsirash të pershtatshme për biznes shërbime doganore, shfrytëzim

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

**Neni 4**

**Selia**

**SELIA:** Selia qendrore e shoqërisë është në Tiranë, në adresën: RRUGA FERIT XHAJKO ND 13 H 14 AP 5 NJESIA ADMINISTRATIVE 8 1017 TIRANË Selia qendrore e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo edhe jashtë saj.

**KREU II**

**Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

**KAPITALI THEMELTAR 100.000 LEKE**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është në vlerën 100.000 leke (njëqind mijë) leke. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është ndarë në 2 kuota (pjesë) Një kuote ka gjithashtu vlerën e një vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është shlyer 60% nga Michele de Cristofaro dhe 40% nga Gerta Kosova.

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk

mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkoet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Cdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

### **KREU III**

#### **Organet vendimmarrese dhe drejtuese**

#### **Neni 8**

##### **Organi vendimmarrës**

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi vetëm vendimmarrës që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorve
- c) Ndryshimin e statutit
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e permendur në shkronjën "B"



- e) Emërimin e shkarkimin i likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- i) Cështje të tjera nga ligji apo statuti

#### **Neni 9**

#### **Thirrja e mbledhjes së asamblesë**

Asambleja mund të thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi bëhet jo më vonë se 7 ditë para mbledhjes.

#### **Neni 10**

#### **Korumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë orkatët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave. Në rastin kur duhet vendosur për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" ajo mund të marrë vendime vetëm nëse janë ortakët që zotërojnë më shumë se gjysma e numrit total të aksioneve.

#### **Neni 11**

#### **Administrimi**

Ortakët e vetëm të shoqërisë emërojnë Znj. Gerta KOSOVA si administrator. Afati i emërimit është 5(pesë) vjet nga dita e themelimit, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 12**

#### **Kompetencat e administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryej të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë



- b) Përfaqësojë shoqërinë ne institucione
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë
- d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor
- e) Kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme te shoqërisë siç parashikon ligji për QKR-në
- f) Si dhe çdo veprim tjetër të parashikuar në ligj

### **Neni 13**

#### **Përgjegjësite e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë dhe të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve tëveshjeve të pa miratuara që l sjellin dëm shoqërisë i ngarkohen administratorit, për tu përballur në mënyrë individuale.

### **KREU IV**

### **Neni 14**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i pare fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKR dhe mbyllet në 31 Dhjetor.

### **Neni 15**

#### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë. Në përfundim të kontrollit ai përgatit raportin me shkrim për njerren e rezultatit të bilancit financiar vjetor dhe ja paraqet ortakeve.

Shoqëria zbaton standartet kombëtare te kontabilitetit.



**KREU V**  
**Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 15**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Me vendim të Asamblesë së Ortakëve
- b) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- c) Me vendim gjykate
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007” Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 16**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së asamblesë së ortakëve, në përputhje me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2012” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**Neni 17**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “ Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 18**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



**ORTAKET**

**E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**GAIA CONSULTING SOLUTIONS**

**MICHELE DE CRISTOFARO**



**GERTA KOSOVA**

